



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 243, datë 20.4.2023

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.748, DATË 11.6.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË
DHE SHTESA MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PERSONELIT
AKADEMIK TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lidhja nr.1, e vendimit nr.748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të një njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, përballohen, si më poshtë vijon:
 - a) Për nivelet e pagave sipas kufirit minimal (kolona 2, e lidhjes nr.1), nga fondet e kontingjencës, të miratuara për vitin 2023;

b) Për çdo nivel page të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal (kolona 3, e lidhjes nr.1), nga të ardhurat e veta të institucioneve publike të arsimit të lartë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI


BELINDA BALLUKU

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik, në institucionet Publike të Arsimit të Lartë

Nr. Rendor	Pozicioni/kategoria	Paga	
		Kufiri minimal	Kufiri maksimal
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>
1	Rektor (Titullar i institucionit) me titullin "Profesor".	179 400	208 910
2	Zëvendësrektor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	169 800	197 600
3	Zëvendësrektor me gradën shkencore "Doktor (PHD)".	167 520	195 000
4	Dekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	169 800	197 600
5	Zëvendësdekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	155 400	180 960
6	Zëvendësdekan nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
7	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	159 000	185 120
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
9	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	159 000	185 120
10	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
11	Profesor.	155 400	180 960
12	Profesor i Asociuar.	135 000	157 300
13	Lektorë.	116 040	135 005
14	Asistent Lektorë.	94 200	109 720